

V E N D I M
Nr.418, datë 9.7.1998

**PËR PROCEDURAT E LIKUIDIMIT TË NDËRMARRJEVE TË FALIMENTUARA NË
RRUGË ADMINISTRATIVE**

(Ndryshuar me vendimin nr. 113, datë 18.3.1999; nr. 409, datë 31.8.1999; nr. 272, datë 20.6.2002)

(I përditësuar)

Në zbatim të dekretit të Presidentit të Republikës nr.1561, datë 25.7.1996 “Për një shtesë në ligjin nr.8017, datë 25.7.1995 “Për procedurat e falimentimit”” miratuar me ligjin nr.8140, datë 5.9.1996, me propozimin e *Ministritë përgjegjëse për industrinë*, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpalljen e falimentimit dhe të likuidimit në rrugë administrative të këtyre ndërmarrjeve:

Uzina 12 dhe Nikel-Kobaltit në Elbasan, Uzina e sodë-PVC-së në Vlorë, Fabrika e letrës Kavajë, Uzina e Superfosfatit Laç, (pjesa e papërfshirë në kapitalin e sh.a., Superfosfati Kurbin), Fabrika e Çorapeve, Korçë.

2. Likuidimi i ndërmarrjeve të shpallura të falimentuara kryhet nga *Ministria përgjegjëse për industrinë*.

3. Caktimi i likuidatorit ose likuidatorëve, miratohet nga *Ministri përgjegjës për industrinë*.

4. Shitja e ndërmarrjeve në likuidim bëhet sipas procedurave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 20.3.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet dhe procedurat e shitjes”, me miratimin e Ministrit përgjegjës për industrinë.

Mjetet e xhiros mund të shiten në treg të lirë, me çmimet korente.

5. Me miratimin e *Ministrit përgjegjës për industrinë*, mbi bazën e raportit të ekspertëve vlerësues, mund të nxirren jashtë përdorimit linja e reparte të ndërmarrjeve të shpallura të falimentuara në rrugë administrative.

6. *Ministri përgjegjës për industrinë* miraton dhe nxjerr udhëzime të posaçme për fillimin dhe zbatimin e procedurave të demolimit, për linjat e repartet e nxjerra jashtë përdorimit, sipas pikës 5 të këtij vendimi.

Shpenzimet e demolimit përballohen me fondet që sigurohen nga shitja e mbetjeve të dala prej tij.

7. Për objektet e ndërmarrjeve të falimentuara, që janë në procesin e likuidimit dhe që deri në datën e daljes së këtij vendimi janë zënë nga familjarë, të zbatohen procedurat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr.197, datë 20.3.1998 “Për nxjerrjen jashtë përdorimit të objekteve që nuk kanë qenë e mundur të shiten”.

8. Arkëtimet në lekë të vlerave të shitjes së pasurisë dhe të detyrimeve debitore të ndërmarrjes në likuidim derdhen në llogarinë e hapur prej saj, pranë Bankës Kombëtare Tregtare.

Bankave, organeve të tatimeve, si dhe organeve të tjera shtetërore u ndalohet të vënë dorë në llogarinë e veçantë të ndërmarrjes në likuidim.

Mjetet monetare të kësaj llogarie disponohen vetëm me urdhër të *Ministrit përgjegjës për industrinë*.

Përdorimi i të ardhurave në lekë bëhet me miratimin e *Ministrit përgjegjës për industrinë* sipas kësaj radhe:

a) për të përballuar pagat dhe shtesat mbi pagë për punonjësit e ndërmarrjes në likuidim;

b) për shlyerjen e detyrimeve, deri në kufirin që lejojnë shumat e arkëtuara në lekë.

Shlyerja e detyrimeve ndaj kreditorëve mund të bëhet edhe pjesë-pjesë, pa pritur likuidimin e plotë të ndërmarrjes. Radha e shlyerjes së kreditorëve miratohet nga *Ministri përgjegjës për industrinë*.

c) për të përballuar të gjitha shpenzimet e tjera, që lidhen me administrimin, ruajtjen dhe likuidimin e ndërmarrjes.

9. Teprica që mund të rezultojë, pasi të zbriten nga totali i të ardhurave në lekë përdorimet sipas pikës 8 të këtij vendimi, me miratimin e Ministrisë së Financave, derdhet në Buxhetin e Shtetit.

10. Ngarkohet *Ministria përgjegjëse për industrinë* për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse për të.

11. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.620, datë 16.9.1996 “Për shpalljen e falimentimit dhe kalimin në likuidim të disa ndërmarrjeve në varësi të Agjencisë së Ristrukturimit të Ndërmarrjeve”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano